

AKTI THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR

OKSI SHPK

ME SELI NË TIRANË

Sot, më date 24 Gusht 2023, në Tiranë,Ortakët:

Z. Marco Mazzanti , Shtetas Italian, i lindur më date 16.02.1966 në Rome(RM), person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me numer pasaporte YC1639537,

Z. Claudio Faccini, Shtetas Italian, i lindur më date 10.05.1967 në Rome(RM), person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me numer pasaporte YB3791714,

Z. Vittorio Giannelli , Shtetas Italian, i lindur më date 31.05.1968 në Rome(RM) person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me numer karte identitet CA83140AB ,

vendosën të krijojnë shoqërinë **OKSI Sh.p.k**, një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat si më poshtë:

NENI 1.

SHOQËRIA TREGTARE **OKSI Sh.p.k** përbëhet në formën e Shoqërisë tregtare sipas ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" (në vazhdim Shoqëria).

Kompania është Person Juridik Privat Shqiptar. Zyra e kompanisë ndodhet në qytetin e Tiranës.Ortakët vendosin për transferimin e selisë në një vend tjetër si dhe për shtimin e një adrese sekondare në Shqipëri ose jashtë saj.

NENI 2.

Emri i Shoqërisë

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj me emrin tregtar **OKSI Sh.p.k** .

NENI 3.

Objekti i veprimtarisë ekonomike

Shoqëria ka për objekt - në përputhje me dispozitat e ligjit - këto aktivitete:

1.Sherbim marketingu dhe komunikimit



2.Menaxhim dhe zhvillim i platformave Softuerike

3.Platforma e Menaxhimit të mesimdhënies,LMS

4.Call Center

NENI 4.

Selia e kompanisë



Selia e shoqërisë ndodhet në adresën:

Yzberisht , Rr. Sabri Prevazi, Kati 8, AP 3, Pallati Vila L, Shkalla 1, Tirane

NENI 5.

Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi i ortakëve themelues të shoqërisë në vlerën 10,000(dhjetë mijë leke)dhe ndahet në 3(tre) kuota.

Themeluesit marrin ne pronesi kuotat e tyre ne kapitalin themeltar, në përputhje me kontributin e tyre.

Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin fillestar ndahet si më poshtë:

Z. Marco Mazzanti, 1 kuotë,me vlerën 4500 Lekë, zotëron 45% (dyzetë e pesë)

Z. Claudio Faccini, 1 kuotë,me vlerën 4500 Lekë, zotëron 45% (dyzetë e pesë)

Z. Vittorio Giannelli, 1 kuotë,me vlerën 1000 Lekë, zotëron 10% (dhjetë)

NENI 6.

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Kompania ushtron veprimtarinë e saj për një periudhë kohore të pacaktuar.

NENI 7.

Organet drejtuese

Referuar ligjit n. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë krijohen si më poshtë:



1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
2. Administratori.

Forma dhe rregullat e organizimit të Shoqërisë janë të parashikuara në statutin e Shoqërisë.

Shoqëria fillimisht administrohet nga një Administrator i vetëm i cili do të qëndrojë në detyrë për 5 vjet, i rinovueshëm, përveç rasteve kur revokohet ose jep dorëheqjen, ose për arsye të tjera ligjore.

Administrator i Shoqërisë i cili pranon, do të jetë **Znj.Rexhina Ismailaj**, Shtetase Shqiptare, e lindur më datë 29.06.1995 në Dushk, Shqiperi, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me numer ID: J55629028M.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, publik ose privat, gjithashtu në marrëdhënie juridike me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto kompetenca në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.



Shoqëria administrohet nga një Administartor i vetëm, edhe jo ortak, ose nga disa administatore edhe jo ortakë, sipas asaj që është përcaktuar në momentin e emërimit.

Kur administrimi i shoqërisë u është besuar disa personave, vendimi i emërimit përcakton në mënyrë alternative:

a) nëse admidnistratorët do të funksionojnë në mënyrë kolegjiale, duke formuar kështu këshillin e administrimit;

b) nëse administrimi i është caktuar veçmas apo bashkërisht.

NENI 8.

Organizimi dhe funksionimi i Shoqërisë, hapja e zyrave apo degëve dytësore do të bëhet në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar dhe të Statutit.

NENI 9.

Punonjësit dhe të ngarkuarit me drejtimit e Shoqërisë janë përgjegjës dhe duhet të kompensojnë kompaninë për dëmet e shkaktuara me dashje për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 10.

Ligji në fuqi

Veprimtaria e shoqërisë do të drejtohet nga rregullat e statutit të nënshkruar nga anëtarët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 11.

Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me themelimin e shoqërisë do të zgjidhet nga ortakët, në të kundërt mosmarrëveshjet do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethi Tiranë.

NENI 12.

Dispozitat përfundimtare

Akti i themelimit pasi u lexua nga anëtarët përbërës, u konstatua në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe nënshkruhet pa asnjë vërejtje.

ORTAKET THEMELUES

Z. Marco Mazzanti



Z. Claudio Faccini



Z. Vittorio Giannelli

